



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 25.06.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion i Qendrës Ditore të Moshuarve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punë ndërtimi 45000000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

23,701,897.80 (njëzet e tre milion e shtatëqind e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë) Lek pa TVSH.

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.167, datë 04/05/2026, me Nr.5864 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t`u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumentet sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i projektimit në Bashkinë Durrës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i punës në bazë të urdhrit Nr.167, datë 04/05/2026, me Nr. 5864 prot., objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 23,701,897.80 (*njëzet e tre milion e shtatëqind e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë*) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata “Rikonstruksion i Qendrës Ditore të Moshuarve”. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së Rikonstruksion i Qendrës Ditore të Moshuarve, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare 2023, 2024, 2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të

realizimit me sukses të kontratës. Kriteri është ligjërisht i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.*

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërisht i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.167, datë 04/05/2026, me Nr.5864 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentet e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;

- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.1** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:*

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,*
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim

operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentet e kërkuara sipas pikave (1.a-1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentet e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjelle kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve të realizuara me sukses përbëjnë një tregues të rëndësishëm të kapacitetit profesional të operatorit ekonomik dhe aftësisë së tij për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Për qëllime kualifikimi, punime të ngjashme konsiderohen: furnizim dhe montim i dyerve dhe dritareve duralumini/plastike, veshje fasade me polistiren EPS me trashësi $t = 5 \text{ cm} + \text{rrjetë} + \text{suva}$, suvatime me grafiato, si dhe punime bojatisjeje (bojë hidroplastike dhe bojë vaji), sipas zërave të preventivit të kësaj kontrate. Operatori ekonomik ose bashkimi i operatorëve ekonomikë duhet të ketë realizuar kontrata të ngjashme me natyrën dhe volumin e punimeve objekt prokurimi.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotësuar sipas standardit.

AK ka kërkuar këto dokumente në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim:

- NP – 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- NP – 7 A** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje
- NP – 12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS – 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS – 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- NS – 12 A** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit
- NS – 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-3 A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Në këtë kategori përfshihen të gjitha zërat e preventivit, pasi objekti i kontratës konsiston në rikonstruksion të një objekti ekzistues, duke përfshirë punime ndërtimi, përmirësimi dhe rifiniture të ndryshme sipas projektit dhe specifikimeve teknike.	A (0- 20 milionë lekë)
NP-7A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm > F.V. Tub xingato dhe rakorderi ~ 1 " Pjese speciale çel Ø~200 > F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 > F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 > "F.V. Saracineska bronzi Ø 2 "" = 50 mm >" F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm > F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 40 > F.V. WC allafrenga > F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi > F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte > F.V. Rezervuari zingato 1000 litra > F.V. Lavapjate llamarine >	A (0- 20 milionë lekë)
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet e inxhinierisë së mjedisit në një objekt civil përfshijnë realizimin e sistemeve të ujësjiellësit, kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të shiut, si dhe sistemet e drenazimit dhe trajtimit të ujërave. Këto punime sigurojnë funksionimin e duhur të objektit, mbrojtjen e strukturave nga lagështia dhe përputhshmërinë me kërkesat mjedisore dhe teknike në fuqi.	A (0- 20 milionë lekë)
NS-1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje suvatim i jashtëm > Prishje mur tulle me pastrim > Prishje suvatim muri i brendshëm >	A (0- 20 milionë lekë)

		Prishje suvatim solete (h<4m) > Prishje shtrese h/izolim tarace > Prishja e rrjetit ekzistues elektrike > Prishja e rrjetit ekzistues hidraulik > Prishje shtresa betoni > Prishje trotuari ekzistues > Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallësh > Heqje pllaka dysHEMEJE > Heqje bazamake shkallësh > Heqje pllakash majolike > Heqje ulluk shkarkimi plastik vertikal "Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese	
NS-4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Shtrese me pllaka grez porcelanato > Dritare d/alumini dyfi xh. > F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara > F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham > Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-15 > Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m > Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 > "Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah >" Veshje me pllake majolike > Suvatim me grafiato h > 4 m > Boje hidroplastike > Boje hidroplastike cilesi e larte > F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm >	A (0- 20 milionë lekë)
NS-12 A	Impiante teknologjike , termike dhe te kondicionimit	Kondicioner – 18000 BTU Inverter, >	A (0- 20 milionë lekë)
NS-14 A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	F.V. Kasete plastike KE me 36 modular (vende) > F.V. Kasete plastike KE me 12 modular (vende) > F.V. Panel i matjes se energjiise 1/3 fazor, 10 poste >	A (0- 20 milionë lekë)

		F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A > F.V. Automat magneto-termik 380V,63A, 4P > F.V. Automat magneto-termik 380V,40A, 4P,Id=0.03A > F.V. Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A > F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A > F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A > F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A > F.V. Llampe sinjalizimi 220V;1.2w > F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm² > F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm² > F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm² > F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm² > F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm² > F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm², i zhveshur > F.V. Tub plastmasi Ø 14-17mm > F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm > F.V. Çelesa e priza 10 A > F.V. Kuti suport pllaket 2 mod > F.V. Kuti suport pllaket 4 mod > F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11w,IP40 > F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm > F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm > F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m > "F.V. kuti shperndarese PT7,PT8, PT11 >" "Ndricues Katror LED 50w , 4000-6000K,3200lm, 600*600mm Ndricues katror LED me 18w , 4000K,1800lm, > Priza per internet RJ45 Komplet > Kabell interneti cad 6 > FV Rack 32HU 800x800mm duke perfshire te gjithë aksesoret dhe ventilatoret e ftohjes >	
--	--	---	--

2.3.3 Një punësim minimalisht prej 37 (tridhjetë e shtatë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpaket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 37 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë,

kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar ne kater elementet e strukturës se kostos (material, punëtori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min 37 punonjës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te përfshirë ne licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- a. 1 (një) Arkitekt
- b. 1 (një) Inxhinier Ndertimi
- c. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- d. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- e. 1 (një) Inxhinier Elektrik
- f. 1 (një) Inxhinier Elektronik
- g. 1 (një) Inxhinier Topograf

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kjo kërkesë mbështetet ne nenin 77, pika 4 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” te VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,

profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

- **Arkitekt** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve arkitekturore sipas projektit arkitektonik dhe specifikimeve teknike të miratuara. Ai mbikëqyr në veçanti punimet e fasadës,

përfshirë sistemin e veshjes me polistiren EPS, rrjetë dhe suva, si dhe detajet e lidhjeve dhe përfundimeve estetike. Gjithashtu kontrollon cilësinë dhe uniformitetin e suvatimeve dhe punimeve të lyerjes (bojë hidroplastike dhe bojë vaji), duke siguruar përputhshmëri me projektin dhe cilësi të lartë të rifiniturës. Arkitekti garanton gjithashtu integrimin korrekt të elementeve si dritaret dhe dyert me fasadën dhe rifiniturat, në bashkëpunim me stafin teknik të objektit.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për organizimin, ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të punimeve në kantier, në përputhje me projektin e zbatimit, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi. Ai siguron koordinimin e punimeve strukturore dhe ndërtimore, mbikëqyr cilësinë e materialeve dhe metodologjinë e punës gjatë realizimit të zërave të preventivit, përfshirë punimet e rikonstruksionit, fasadës, suvatimeve dhe rifiniturave. Gjithashtu, inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e afateve kohore, organizimin e fuqisë punëtore dhe zgjidhjen e problematikave teknike që mund të lindin gjatë procesit të punimeve, duke garantuar realizimin e kontratës me cilësi dhe në përputhje me projektin.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike sipas projektit dhe specifikimeve teknike, duke siguruar funksionimin korrekt të sistemit të shkarkimit të ujërave. Prania e tij është e domosdoshme për punimet e çmontimit dhe montimit të tubave të shkarkimit, pasi këto ndërhyrje kërkojnë verifikim teknik të rrjetit ekzistues, realizim korrekt të lidhjeve dhe sigurim të hermeticitetit të sistemit, në mënyrë që të shmangen defekte, rrjedhje dhe probleme në funksionim pas përfundimit të punimeve.
- **Inxhinier Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike sipas projektit dhe specifikimeve teknike, duke garantuar funksionimin korrekt të sistemeve të kondicionimit. Në kuadër të punimeve të zhvendosjes (çmontim dhe montim) të kondicionerëve, prania e inxhinierit mekanik është e domosdoshme për të siguruar çmontimin e sigurt të njësive ekzistuese, ruajtjen e gjendjes teknike të pajisjeve dhe riinstalimin korrekt të tyre në pozicionet e reja. Ai siguron gjithashtu lidhjen e saktë të tubacioneve të bakrit, kontrollin e hermeticitetit të sistemit dhe funksionimin e duhur të pajisjeve pas montimit, duke shmangur defektet teknike dhe humbjet e gazit ftohës.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për projektimin, instalimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektrike në një objekt civil, duke përfshirë instalimet e ndriçimit, prizave dhe shpërndarjes së energjisë, llogaritjen e ngarkesave dhe dimensionimin e kabllave dhe paneleve elektrike, instalimin e paneleve dhe rrjeteve shpërndarëse, sistemet e ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm, tokëzimin dhe mbrojtjen nga shkarkimet elektrike, sistemet e emergjencës si dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet teknike dhe të sigurisë.
- **Inxhinieri Elektronik** është përgjegjës për zbatimin, montimin dhe funksionimin e sistemit të kabinetit IT (Rack 32HU 800x800 mm), duke përfshirë instalimin e pajisjeve të rrjetit si patch panel 24 porta CAT6 dhe switch 24 porta me uplink Ethernet/SFP, si dhe të gjitha lidhjet e nevojshme të kabllave dhe aksesoreve, duke garantuar organizimin e rrjetit, funksionimin korrekt të sistemit të komunikimit të të dhënave, si dhe ftohjen dhe mbrojtjen e pajisjeve brenda rack-ut në përputhje me standardet teknike.

- **Inxhinieri Topograf** është përgjegjës për kryerjen e matjeve dhe rilevimeve në terren, përcaktimin e kuotave, boshteve dhe kufijve të objektit, hartimin e planeve topografike dhe vendosjen e pikave të kontrollit gjatë ndërtimit, si dhe për verifikimin e saktësisë së pozicionimit të elementeve konstruktive në përputhje me projektin dhe standardet teknike.

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të punësuar 1 (një) person të certifikuar si Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit ose Inxhinier Materialelesh, për kryerjen e të gjitha testeve në objekt. Ky person duhet të vërtetohet me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë dhe/ose certifikatë përkatëse, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit, të deklaruara përpara datës së hapjes së ofertave, konkretisht:

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për përfshirjen e një Specialist për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit / Inxhinier Materialelesh është vendosur në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me natyrën e kontratës, specifikimet teknike dhe zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë përdorimin e materialeve të ndryshme ndërtimi, për të cilat kërkohet kontroll dhe verifikim i cilësisë dhe performancës sipas standardeve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit / Inxhinier Materialelesh është përgjegjës për vlerësimin, kontrollin dhe testimin e materialeve dhe produkteve të ndërtimit, me qëllim garantimin që ato përmbushin kërkesat teknike, standardet e cilësisë dhe siguri të përcaktuara në projekt dhe në legjislacionin në fuqi.

Ky profil profesional duhet të zotërojë njohuri të thelluara mbi metodat e testimit laboratorik dhe në terren, standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe karakteristikat teknike të materialeve të ndërtimit, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e kontratës.

Përfshirja e këtij specialisti në stafin e operatorit ekonomik është thelbësore për garantimin e cilësisë së punimeve, reduktimin e riskut të defekteve teknike, si dhe për sigurimin e një zbatimi korrekt dhe në përputhje me standardet e kërkuara të kontratës objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017

“Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Specialist Pllakashtrimi	2
Specialist Duralumini	3
Specialist Marangoz (punime dyersh)	2
Specialist Suvatimi	2
Specialist Bojatisje	2
Specialist Elektrik	2
Specialist Hidroizolimi	1
Specialist IT	1
Specialist Instalime ngrohje–ftohje	1
Specialist Termoizolimi	2
Shofer	2
Automakinist	3

Krahas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë. Pavaresisht numrit të certifikimeve që mund të kenë punonjësit e mesiperm, për këtë objekt prokurimi nuk do të pranohet që një punonjës të paraqesë më shumë se dy certifikime, pra nuk do të kryejë më shumë se dy procese pune njëkohësisht :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. i certifikatës/dip lomës	Nr. Nipt (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;*
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftësimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhrin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës.*

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të të cilave janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku përcaktohet se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;” Urdhërit nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit” të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës, neni 3/a të urdhërit ku përcaktohet se: “a) “Dëshmia e Aftësisë Profesionale” (DAP), dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi përcaktimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga aksidentet në punë dhe njohuri teknike dhe profesionale për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke;” dhe neni 8/1/c ku përcaktohet se: “1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë: c) Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: -autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak manovratorëve u jepet dëshmi për automakinist.”

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij si dhe te figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- b) 3 (tre) punonjës të pajisur me certifikatë: “Specialist për punimet në lartësi”, sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) 1 (një) punonjës i certifikuar për kryerjen e punimeve speciale të saldimit për tubat e bakrit, sipas kërkesave të standardit EN ISO 13585:2012, me certifikatë të vlefshme të lëshuar nga organizma certifikues, shoqëri të licencuara/akredituara ose organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) 1 (një) punonjës Saldimi me elektrofuzion , të jenë të pajisur dhe certifikuar me: SSH/EN 13067:2020 , për punimet e saldimit të tubacioneve. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik do të paraqes certifikatat e lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Certifikatë

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për “Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standardeve ligjore në fuqi.

- “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete në kantier per trajnimin e punonjësve te kantierit per minimimin e aksidenteve ne pune.

-Punonjësit e pajisur me certifikaten e Trajnimit për “Punime në lartësi” është sipas V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" në projekt-preventiv ka punime skelerie ne lartësi, te cilën e ben te nevojshme kërkesa për punonjës të certifikuar dhe trajnuar per punime na lartësi.

- Kërkesa për punonjës të certifikuar për saldim sipas standardit EN ISO 13585:2012, të lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika

e Shqipërisë, është vendosur në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, të cilat përfshijnë çmontimin dhe montimin e rreth 11 (njembedhjet) njësive kondicionimi, si dhe ndërhyrje në tubacionet e bakrit që shërbejnë për lidhjen dhe funksionimin e sistemit të klimatizimit. Gjatë këtyre proceseve kërkohen ndërhyrje të specializuara në tubacionet e bakrit, përfshirë prerje, bashkime dhe ribashkime (brazim/saldim i fortë), të cilat duhet të kryhen me teknika të certifikuara për të garantuar hermeticitet të plotë të sistemit, shmangien e rrjedhjeve të gazit ftohës dhe sigurimin e funksionimit normal të sistemit të kondicionimit.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një punonjës të certifikuar sipas standardit EN ISO 13585:2012, i cili garanton aftësinë profesionale për realizimin e lidhjeve të tubacioneve të bakrit në mënyrë të saktë, të sigurt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë.

Mungesa e një specialisti të tillë rrit rrezikun e defekteve teknike, humbjes së gazit ftohës, uljes së eficiencës së sistemit dhe kostove shtesë për riparime, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e instalimeve. Për rrjedhojë, kërkesa për saldator të certifikuar konsiderohet e domosdoshme dhe proporcionale me natyrën dhe volumn e punimeve të parashikuara në projekt.

- Kërkesa për punonjës të certifikuar për saldim me elektrofuzion sipas standardit SSH/EN 13067:2020 është e domosdoshme pasi punimet përfshijnë montimin e tubacioneve dhe rakorderive të ujësjellësit, ku realizimi i lidhjeve të tubave plastikë (PE/HDPE) me metodën e elektrofuzionit kërkon aftësi dhe kualifikim të posaçëm për të garantuar hermeticitet, qëndrueshmëri dhe siguri të rrjetit. Certifikimi sipas këtij standardi siguron që punonjësit kanë kompetencën teknike për të kryer saldime të sakta dhe të testuara sipas normave evropiane, duke minimizuar rrezikun e rrjedhjeve dhe defekteve në sistemin e ujësjellësit, dhe duke garantuar përputhshmërinë me kërkesat teknike të projektit dhe legjislacionin në fuqi për cilësinë e punimeve publike.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Automjet me kosh	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Karroçë dore ≥ 80 lt	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Gjenerator ≥ 5 kw	1 copë	Pronësi ose me qira

5	Depozitë uji deri në 1000 lt	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
7	Damper me goma (MT) me kapacitet mbajtës 1 - 4 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
8	Ashensor kantieri për ngritjen e materialeve	1 copë	Pronësi ose me qira
9	Minifadrom e pajisur me pirun teleskopik për ngritjen e materjaleve (mjet teknologjik me goma)	1 copë	Pronësi ose me qira
10	Skeleri metalike me aksesoret plotesuese	700 m2	Pronësi ose me qira
11	Sharrë profesionale për D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
12	Makineri për ngjitje D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
13	Makineri për pastrimin dhe rifiniturën e D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
14	Frezë profesionale për frezimin e fermave në D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
15	Pantograf për hapjen e bravave në D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	46 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	46 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq 5\text{kg}$	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	5 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Syze pune transparente	5 copë	Pronësi ose me qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikatë për transport mallrash.

b) Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet me targa të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës së shoqërisë ofertuese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryej verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Mjetet, pajisjet dhe elementet e sigurisë të listuara më poshtë janë përcaktuar në përputhje me natyrën e punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë punime ndërtimi, montimi, transporti dhe instalimi në lartësi, si dhe punime të ndryshme rifiniture. Këto kërkesa janë vendosur me qëllim garantimin e realizimit të punimeve në kohë, me cilësi dhe në përputhje me standardet e sigurisë në kantier.

Kamioni me vinç dhe automjeti me kosh shërbejnë për ngritjen, transportin dhe pozicionimin e materialeve dhe punëtorëve në lartësi, veçanërisht për montimin e elementeve të fasadës dhe dritareve. Kamionët vetëshkarkues dhe damperët me goma përdoren për transportin e materialeve ndërtimore dhe mbetjeve nga kantieri, duke siguruar vijueshmërinë e punimeve dhe menaxhimin efikas të logistikës në objekt.

Karroca e dorës, depozita e ujit dhe gjeneratori sigurojnë funksionimin e përditshëm të kantierit, furnizimin me energji elektrike në rast mungese rrjeti dhe transportin e materialeve në distanca të shkurtra brenda objektit. Ashensori i kantierit dhe minifadroma me pirun teleskopik përdoren për ngritjen e materialeve në kate dhe për pozicionimin e tyre në zona të vështira aksesimi. Skleria metalike përbën elementin kryesor të sigurisë dhe aksesit në lartësi, duke mundësuar realizimin e punimeve të fasadës, suvatimeve dhe rifiniturave në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Makineritë për d/alumin plastik (sharrë profesionale, makineri për ngjitje, makineri për pastrim dhe rifiniturë, frezë profesionale dhe pantograf) shërbejnë për prerjen, përpunimin, montimin dhe përfundimin e elementeve të dritareve dhe dyerve, duke garantuar saktësi dimensionale, cilësi të lartë montimi dhe përputhshmëri me specifikimet teknike të projektit.

Helmetat mbrojtëse, jelekët me shirita fosforeshentë dhe syzet mbrojtëse janë pajisje të detyrueshme të sigurisë individuale (PPE), të cilat sigurojnë mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e mundshme në kantier, si goditje mekanike, rënie objektësh dhe punime në kushte të kufizuara shikueshmërie.

Fikëset e zjarrit të lëvizshme sigurojnë reagim të menjëhershëm në rast emergjencash zjarri, ndërsa tabela e sigurisë teknike shërben për informimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve mbi rregullat e sigurisë në kantier. Kutia e ndihmës së shpejtë garanton ndërhyrje të menjëhershme në rast aksidentesh të vogla apo emergjencash shëndetësore.

Në tërësi, këto mjete dhe pajisje janë të domosdoshme për garantimin e një procesi pune të sigurt, efikas dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë në ndërtim, duke siguruar realizimin me sukses të kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqesë ISO-t në bazë te zërave te punimeve qe ka marre përsipër te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.11 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, grupi i specifikimeve, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara sipas pikës 2.4.1 germa “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjesëtim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.4.3/a Për të mundur verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues, për materialet: **dritare duralumini/plastike, dyer të brendshme, hidroizolim, bojë, pllaka gres porcelanato, llaç mbushës, fino, grafiato, pajisje elektrike dhe pajisje kondicionimi**, duhet të paraqesë katalogët ose fragmente të katalogëve të prodhuesit/distributorit zyrtar, ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/distributori zyrtar, ku të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Katalogët ose skedat teknike duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të materialeve, në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë nëse materialet e ofruara, të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së punimeve/shërbimeve, përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Katalogët ose skedat teknike duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

2.4.3/b Operatori ekonomik ofertues, për produktet: **dritare duralumini/plastike, dyer të brendshme, hidroizolim, bojë, pllaka gres porcelanato, llaç mbushës, fino, grafiato, pajisje elektrike dhe pajisje kondicionimi**, të cilat do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës dhe për të cilat kërkohen shprehimisht standarde teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë **autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar**.

Gjithashtu, operatori ekonomik duhet të paraqesë **Deklaratë të Konformitetit (Declaration of Conformity)** ose **Certifikatë CE të Konformitetit**, ose **raporte testimi** të lëshuara nga organizma të notifikuar evropianë apo laboratorë/organizma testues të akredituar, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së standardeve teknike të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesat e parashikuara në pikat 2.3.9/a dhe 2.3.9/b janë vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe nenin 45, pika 1 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe përbërjen e preventivit, ku përfshihen materiale ndërtimi me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën, qëndrueshmërinë dhe cilësinë përfundimtare të punimeve, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të domosdoshme vendosjen e kërkesave të detajuara për dokumentacion teknik, autorizim prodhuesi dhe certifikim të konformitetit të produkteve.

Këto kërkesa nuk janë formale, por thelbësore për garantimin e cilësisë së investimit publik dhe për shmangien e rreziqeve që mund të lindin nga përdorimi i materialeve jo të standardizuara, jo të testuara ose me origjinë të paqartë. Në mungesë të këtyre dokumenteve, Autoriteti Kontraktor do të ishte i kufizuar në verifikimin real të cilësisë së produkteve përpara dhe gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e katalogëve ose skedave teknike të prodhuesit/distributorit zyrtar është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë një bazë të qartë dhe të verifikueshme të të dhënave teknike të çdo materiali të ofruar. Kjo mundëson krahasimin e drejtpërdrejtë midis specifikimeve të kërkuara në DST dhe karakteristikave reale të produktit, duke shmangur devijimet teknike dhe interpretimet subjektive të ofertuesve. Gjithashtu, kjo kërkesë garanton transparencë dhe uniformitet në vlerësim.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar ka për qëllim të sigurojë origjinën dhe gjurmueshmërinë e produkteve, si dhe të verifikojë që operatori ekonomik ka të drejtë reale furnizimi për produktet e ofruara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për materiale që prodhohen

në mënyrë industriale dhe që kërkojnë garanci për cilësinë dhe vazhdimësinë e furnizimit. Në këtë mënyrë shmanget rreziku i përdorimit të produkteve të paautorizuara, të paidentifikuara ose të paqëndrueshme në treg.

Në mënyrë të veçantë, kërkesa për Deklaratë Konformiteti (Declaration of Conformity), Certifikatë CE ose raporte testimi nga organizma të notifikuar evropianë apo laboratorë të akredituar, është thelbësore për garantimin se produktet e ofruara përmbushin standardet teknike dhe rregullatore të Bashkimit Evropian. Certifikimi CE përbën një provë të njohur ndërkombëtarisht se produkti është testuar dhe përputhet me kërkesat bazë të sigurisë, shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për materialet e ndërtimit të përfshira në këtë procedurë, si dritaret, sistemet e fasadave, materialet termoizoluese dhe bojërat, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në performancën energjetike, sigurinë dhe jetëgjatësinë e objektit. Përdorimi i materialeve të certifikuara ul ndjeshëm rrezikun e defekteve teknike, degradimit të shpejtë dhe kostove të mëvonshme të mirëmbajtjes.

Për më tepër, këto kërkesa krijojnë një mekanizëm kontrolli të hershëm në fazën e kualifikimit, duke detyruar operatorët ekonomikë të ofrojnë vetëm produkte të verifikuara dhe të standardizuara, duke rritur konkurrencën cilësore dhe duke shmangur ofertat me produkte të pakonfirmuara teknikisht. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor siguron jo vetëm përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi, por edhe realizimin e një investimi publik me cilësi të lartë, të qëndrueshëm në kohë dhe në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane të ndërtimit.

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: “Rikonstruksion i Qendres Ditore të Moshuarve”, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standardeve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe

përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit